

18 Janar 2021

VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS DHE ZGJEDHJET E PARAKOHSHME: ANALIZË LIGJORE DHE SKENARËT E MUNDSHËM

PËRMBLEDHJE

Në fund të vitit 2020, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se gjashtë muaj pas zgjedhjes së saj, qeveria e Kryeministrit Avdullah Hoti nuk kishte marrë shumicën e votave, si pasojë e votës së pavlefshme të njërës prej 61 votave në Kuvendin e Kosovës i cili ka 120 ulëse. Vota në fjalë ishte e deputetit Etem Arifi i cili para zgjedhjeve ishte dënuar nga gjykata për mashtrim. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i publikuar më 6 janar 2021, detyroi mbajtjen e zgjedhjeve të hershme brenda 40 ditëve – Ushtruesja e Detyrës së Presidentes, caktoi datën e zgjedhjeve, 14 shkurtin e vitit 2021.

Sidoqoftë, qeveria Hoti ishte në krizë edhe para vendimit të gjykatës, me mosmarrëveshje të mëdha mes partnerëve të koalicionit dhe një mungesë të shumicës së mjaftueshme në Kuvend. Koalicioni mes LDK-së, AAK-së dhe NISMA-s (dhe minoriteteve), i udhëhequr nga LDK, nuk dukej se kishte gjasa të siguronte votat në Kuvend për zgjedhjen e presidentit. Vetëm pak para shpërbërjes, Kuvendi arriti të kalojë Buxhetin për vitin 2021. Aktualisht, Kosova gjendet në një vakum institucional, me një Ushtruese të Detyrës së Presidentes (që po ashtu është Kryetare e Kuvendit), Kuvend të shpërbërë dhe qeveri në detyrë.

Ushtruesja e Detyrës së Presidentes, Vjosa Osmani do të kandidojë në zgjedhje dhe ka paralajmëruar formimin e një nisme të re politike që paraqet një sfidë ligjore ndaj pozitës së “përfaqësuesit të unitetit të popullit.” Nëse ajo fiton mandatin e deputetes, presidenca do të mbetet bosh dhe një vakum institucional do të mbizotërojë, deri sa Kuvendi të zgjedhë kryetarin/en e ri/re. Në të gjitha rrethanat, mandati i Ushtrueses së Detyrës së Presidentes, do të përfundojë më 5 maj 2021.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mund që potencialisht të afektojë një numër të përfaqësuesve të njohur të Vetëvendosjes, duke përfshirë edhe liderin e saj Albin Kurtin, të cilët janë gjetur fajtor dhe ndaj të cilëve janë shqiptuar dënimet me kusht. Beteja ka gjasë të vazhdojë, derisa partitë politike mund të kërkojnë interpretime të mëtutjeshme të së drejtës për të qenë kandidat për deputet, e ndoshta edhe për të qenë kryeministër.

Shumë hapa në rrugën drejt krijimit të institucioneve të reja ka gjasë të sfidohen në Gjykatën Kushtetuese, gjë që mund të zvarritë procesin edhe më tutje, si dhe të vë në pikëpyetje legjitimitetin e tij. Posti i presidentit mund të jetë pjesë përbërëse e një marrëveshjeje të koalicionit dhe çelës për formimin e qeverisë dhe jetëgjatësisë së saj. Për të zgjedhur presidentin, kërkohet prezenca e 80 deputetëve në Kuvend (të paktën në dy raundet e para). Për të arritur këtë, palëve do t'ju nevojitet një marrëveshje politike.

Duhet muaj që procesi elektoral i Kosovës të kompletohet duke përfshirë numërimin e votave, rinumërimin e tyre dhe çertifikimin e rezultateve. Afati për inaugurimin e legjislaturës së re është 30 ditë, nga dita e çertifikimit të rezultateve. I gjithë procesi ka mundësi të zgjasë deri në fund të muajit prill, maj, apo edhe qershor.

Spektri politik është larg përafrimit të dallimeve sa i përket zgjedhjes së presidentit të ri. Kosova është duke hyrë në një moment të pashembullt dhe mjaft të pasigurtë. Në këto rrethana, pa shembuj paraprak ligjor, interpretime mund të gjenden vetëm në praktikat e vendeve të tjera. Gjasat për një bllokim të gjatë ligjor, një vakum institucional dhe një cikël të ri zgjedhor, mbesin të larta.

Në këtë kontekst, ekzistojnë tre skenarë të mundshëm:

1. Formimi i një qeverie të re me një shumicë të thjeshtë (të paktën 61 vota) në Kuvend. Në këtë rast, qeveria do të kushtëzohet nga zgjedhja e suksesshme e presidentit të ri (i cili duhet të zgjedhet brenda 60 ditëve pas konstituimit të Kuvendit).

2. Formimi i një qeverie të re me një epërsi të votave (80 vota) e cila do të përfshinte edhe zgjedhjen e presidentit. Kjo do të përfshijë negociata të vështira që nga fillimi, si dhe kompromise të mëdha.

3. Shpërbërja e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja pas dështimit të zgjedhjes së një presidenti të ri brenda 60 ditëve, edhe nëse një qeveri e re është formuar.

Për të shmangur një krizë të gjatë dhe cikle të reja të zgjedhjeve, partitë politike duhet të mbështesin procesin elektoral, të shmangin zvarritjen e procesit të numërimit dhe rinumërimit të votave, si dhe të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për formim të shpejtë të institucioneve të reja. Zgjedhja e presidentit do të kërkojë konsensus dhe bashkëpunim mes partive kryesore politike në Kuvendin e ri.

1 GJYKATA KUSHTETUESE E KONSTATON MUNGESËN E KUSHTETUTSHMËRISË SË QEVERISË HOTI

Më 6 janar 2021, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka publikuar vendimin sipas të cilit **zgjedhja e qeverisë aktuale të Republikës së Kosovës, nuk është bërë në përputhje me nenin 95.3 të Kushtetutës së Kosovës**, duke qenë se nuk ka marrë shumicën e votave në Kuvend.¹ Qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti ishte votuar më 3 qershor 2020, me 61 vota (numri minimal i kërkuar në Kuvend), pasi që qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje ishte rrëzuar pas votimit të mocionit të mosbesimit i zhvilluar më 25 mars 2020.²

Një nga 61 votat në favor të qeverisë ishte ajo e Etem Arifit, deputet nga Partia e Ashkalive për Integrim. Më pak se para një viti, Etem Arifi ishte dënua me një vit e tre muaj burgim për mashtrim. Më 28 mars dhe më 20 gusht 2019, Etem Arifi ishte dënua me një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, me një vit dhe tre muaj burgim.³

Më 6 tetor 2019, ishin mbajtur zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës dhe më 27 nëntor 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i çertifikoi rezultatet e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe Etem Arifin si deputet. Më 26 dhjetor 2019, u mbajt seanca konstituive e Kuvendit, dhe mandati i tij u konfirmua. Etem Arifi vazhdoi të ushtronte funksionin e tij si deputet deri në dorëzimin e tij në polici.

Vendimi i gjykatës erdhi si përgjigje ndaj deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), të cilët kishin parashtruar kërkesë më 11 qershor 2020, për vlerësim të kushtetutshmërisë së votës së Etem Arifit dhe rrjedhimisht – vlerësimin e legjitimitetit të zgjedhjes së qeverisë.⁴ **Etem Arifi nuk e ka fituar mandatin e deputetit në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme**, që shprehimisht thotë se “asnjë person që është dënua me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në tri (3) vitet e fundit, nuk mund të jetë kandidat për deputet,

¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07 / V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*, 6 janar 2021, URL: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-te-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-nr-07-v-014-te-3-qershorit-2020-per-zgjedhjen-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>

² DW, “Kosovo’s government toppled through no-confidence vote over coronavirus response” [Qeveria e Kosovës rrëzohet nga vota e mosbesimit në lidhje me përgjigjen ndaj virusit corona], 25 mars 2020, URL <https://www.dw.com/en/kosovos-government-toppled-through-no-confidence-vote-over-coronavirus-response/a-52919171>

³ Për më shumë detaje, shiko Betimi për Drejtësi, “Deputeti Etem Arifi paraqitet në Qendrën e Paraburgimit për vuajtje të dënimit,” 29 shtator 2020, URL <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-etem-arifi-paraqitet-ne-qendren-e-paraburgimit-per-vuajtje-te-denimit/>

⁴ Kallxo, “Vetëvendosje e dërgon në Kushtetuese çështjen e votimit të deputetit Etem Arifi,” 11 qershor 2020, URL <https://kallxo.com/lajm/vetevendosje-e-dergon-ne-kushtetuese-ceshtjen-e-votimit-te-deputetit-etem-arifi/>

e as të fitojë një mandat të vlefshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës.”⁵

Për të shmangur kaosin ligjor dhe vënien në pikëpyetje të vendimeve paraprake të qeverisë, **aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka efekt prapaveprues** dhe ‘bazuar në parimin e sigurisë juridike, vendimet e qeverisë mbesin në fuqi dhe qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e një qeverie të re.’⁶

2 QEVERIA NË KRIZË DHE PASHMANGSHMËRIA E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

Edhe para këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, **qeveria ishte në një krizë** përderisa problemet, siç janë dialogu Kosovë-Serbi dhe emërimet politike, theksuan mosmarrëveshjet mes partnerëve të koalicionit qeverisës – i përbërë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA dhe partitë e minoriteteve.⁷

Pas dorëheqjes së Presidentit Hashim Thaçi në fillim të nëntorit të vitit 2020, spektri politik ishte larg përafrimit të dallimeve sa i përket zgjedhjes së presidentit të ri.⁸ Kryeministri Hoti kishte theksuar vazhdimisht se partitë duhet të vendosin se a dëshirojnë zgjedhje të reja, apo do të pajtohen për një kandidat konsensual për postin e presidentit.⁹ **Qeveria po ashtu demonstroi qartë se ajo nuk mund të siguronte mbështetjen e (2/3) shumicës** në Kuvend, e cila nevojitet për nisjen e procesit për zgjedhjen e presidentit.

Kështu, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike u miratua në Kuvend pas gjashtë përpjekjeve dhe vetëm me mbështetjen e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në opozitë.¹⁰ Ngjashëm me këtë, Buxheti i vitit 2021 kaloi në fund të dhjetorit, pas vendimit të gjykatës, me mbështetjen e opozitës, për të shmangur një mbyllje të

⁵ Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – Neni 29.1 (q)

⁶ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07 / V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*, 6 janar 2021

⁷ Radio Evropa e Lirë, “Cilat janë telashtet e koalicionit LDK-AAK?” 11 gusht 2020, URL <https://www.evropa-elire.org/a/telashe-ne-koalicionin-qeverises-/30777352.html>

⁸ Presidenti Hashim Thaçi dhe lideri i PDK-së Kadri Veseli, janë akuzuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës të vendosura në Hagë. Për më shumë shiko DW, “Kosovo’s President Hashim Thaci resigns to face war crime trial”, [“Presidenti i Kosovës Hashim Thaci jep dorëheqje për t’u përballur me gjykimin për krim”] 5 nëntor 2020, URL <https://www.dw.com/en/kosovos-president-hashim-thaci-resigns-to-face-war-crime-trial/a-55507770>

⁹ Zëri, “Hoti: Partitë të dakordohen për president të ri ose për zgjedhje të parakohshme,” 13 nëntor 2020, URL <https://zeri.info/aktuale/376980/hoti-partite-te-dakordohen-per-president-te-ri-ose-per-zgjedhje-te-parakohshme/>

¹⁰ Kallxo, “Kalon Ligji i Rimëkëmbjes Ekonomike, qytetarët do mund ta tërheqin 10 përqindëshin nga Trusti,” 4 dhjetor 2020, URL <https://kallxo.com/lajm/kalon-ligji-i-rimekembjes-ekonomike-qytetaret-do-mund-ta-terheqin-10-perqindeshin-nga-trusti/>

menjëhershme. Lëvizja Vetëvendosje insistonte që buxheti do të duhej të kalonte pas zgjedhjeve, në mënyrë që t'i lejohej partisë fituese që të përgatiste agjendën e saj, por në fund edhe ajo votoi për kalimin e buxhetit.

3 POSTI I PRESIDENTIT

Pas dorëheqjes së Presidentit Hashim Thaçi më 5 nëntor 2020, Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, mori funksionin e ushtrueses së detyrës së presidentit(es).

Mandati i ushtrueses së detyrës së presidentit(es) është bërë i ndërlikuar duke qenë se **Ushtruesja aktuale e Detyrës së Presidentes** do të kandidojë në zgjedhjet e ardhshme. Ajo ka paralajmëruar edhe formimin e një nisme të re politike. Gjykata Kushtetuese kishte vendosur më herët se natyra “ushtruese” e detyrës së presidentit **nuk ndalon mbajtjen apo ushtrimin e funksioneve politike apo partiake**.¹¹ Megjithatë, nuk duket se vendimi i njëjtë do të aplikohet në këtë rast konkret, duke qenë se presidenti/ja “përfaqëson unitetin e popullit.”¹² Fushata politike cënon rolin e “përfaqësuesit të unitetit” nga presidentja dhe parimin fundamental – ndarjen e pushteteve.

Duke marrë parasysh popullaritetin e saj, Vjosa Osmani **ka gjasa të fitojë mandatin si deputete dhe kjo do të bënte që ajo të humbë menjëherë rolin e saj si Ushtruese e Detyrës së Presidentes**. Në mungesë të bartjes së rregullt të përgjegjësisë të presidentit, **presidenca do të mbetet bosh dhe një zbrazëti institucionale do të mbizotëronte deri në mbajtjen e seancës konstituive të Kuvendit**. Kushtetuta nuk e trajton këtë çështje dhe kështu, me gjasë, do të krijohet një situatë e komplikuar.

Çertifikimi i rezultateve zakonisht zgjat deri në dy muaj pas ditës së zgjedhjeve. Kuvendi duhet të konstituohet pas 30 ditëve.¹³ Inaugurimi i Kuvendit do të thotë zgjedhja e një kryetari/eje të ri/re të Kuvendit që automatikisht do të marrë rolin e ushtruesit të detyrës së presidentit.¹⁴ Në cilindo skenar, posti i presidentit/es

¹¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit*, 22 dhjetor 2010, URL <https://gjk-ks.org/en/decision/in-the-matter-of-the-referral-submitted-by-acting-president-of-the-republic-of-kosovo-dr-jakup-krasniqi-concerning-the-holding-of-the-office-of-acting-president/>

¹² Kushtetuta e Kosovës – Neni 4

¹³ Historikisht, “procesi i formimit të një Kuvendi funksional e ka paralelizuar atë të zgjedhjes së një Qeverie dhe në fund është kushtëzuar nga arritja e një marrëveshjeje për një koalicion” gjë që ka qenë e mundur “për shkak të zbrazëtive në Kushtetutë dhe në Rregullat e Procedurës së Kuvendit të cilat kanë lejuar abuzime të tilla.” Për më shumë, shiko Grupi për Ballkan, *Kosova 2019: Shmangia e Krizës Pas-zgjedhore – Rrugëtimi nga Certifikimi deri tek Inaugurimi*, 24 nëntor 2019, URL <https://balkansgroup.org/en/kosovo-2019-avoiding-a-post-electoral-crisis-a-roadmap-from-certification-to-inauguration-2/>

¹⁴ Kushtetuta e Kosovës – Neni 90.3 specifikon se “pozita e ushtruesit të detyrës së Presi-

do të mbetet i zbrazët pas 5 majit të vitit 2021. Sipas interpretimeve të tjera, dikush do të duhet të plotësojë Zyrën e Presidentit. Në një situatë të tillë, është e mundur që Vjosa Osmani të vazhdojë të qëndrojë në zyrën presidenciale, deri në konstituimin e Kuvendit.

Kuvendi mund të mbledhet pa pjesëmarrjen e presidentit, por zgjedhja e presidentit do të bëhet një shqetësim i menjëhershëm edhe para zgjedhjes së qeverisë.¹⁵ Dështimi në zgjedhjen e

presidentit brenda 60 ditëve nga fillimi i këtyre procedurave rezulton në shpërbërjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja brenda 45 ditëve.¹⁶ Në këtë rast, në mungesë të një presidenti/eje, Kuvendi është i obliguar që të nisë procedurën menjëherë pas konstituimit të tij. Të paktën një herë në të kaluarën, partitë politike Kosovare kanë arritur të pajtohen për një koalicion të votuar me një epërsi të votave, që ka përfshirë zgjedhjen e qeverisë dhe të presidentit, në të njëjtën kohë.¹⁷

Ka shumë gjasë që kryetari/ja i/e ri/re i/e Kuvendit, do të mbetet në rolin e ushtruesit të detyrës së presidentit, të paktën përkohësisht. Në rast se Kuvendi dështon në zgjedhjen e një presidenti, kryetari/ja i/e re Kuvendit do të mbetet autoriteti i vetëm për shpalljen e zgjedhjeve të reja.¹⁸

Në këto rrethana të pasigurta, interpretime mund të gjenden vetëm në praktikat e vendeve të tjera, përderisa Kushtetuta e Kosovës nuk ka paraparë skenarë të tillë. Kështu, **gjasat për një bllokim të gjatë ligjor, një vakum institucional dhe një cikël të ri zgjedhor, mbesin të larta.**

Kushtetuta e Kosovës – neni 86.3

Çdo qytetar i kualifikuar i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ai/ajo siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës.

dentit të Republikës së Kosovës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë sesa gjashtë (6) muaj.” Mbajtësja aktuale e pozitës, Vjosa Osmani, mori funksionin e Ushtrueses së Detyrës së Presidentes më 5 nëntor 2021, pas dorëheqjes së Presidentit Hashim Thaçi. URL <https://president-ksgov.net/en/news/dr-vjosa-osmani-officially-assumes-the-function-of-the-acting-president-of-kosovo>

¹⁵ Kushtetuta e Kosovës – Neni 66.3

¹⁶ Kushtetuta e Kosovës – Neni 82 dhe 86

¹⁷ Al Jazeera, “Kosovo elects Thaci as new PM,” [Kosova e zgjedhë Thacin si Kryeministër të Ri] 9 janar 2008, URL <https://www.aljazeera.com/news/2008/1/9/kosovo-elects-thaci-as-new-pm>

¹⁸ Kushtetuta e Kosovës – Neni 84.3

Për të zgjedhur presidentin, 80 deputetë (2/3) duhet të jenë prezent në Kuvend, një obligim ky i vështirë për t'u përmbushur duke pasur parasysh klimën e polarizuar politike. Në vitin 2010, në çështjen lidhur me zgjedhjen e Behxhet Pacollit si President të Kosovës, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se deputetët "duhet të ndjehen të obliguar, në bazë të Kushtetutës, Ligjit për Deputetët, Rregullat e Procedurës të Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes, për të marrë pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe t'u përmbahen procedurave të përcaktuara në to, por mbi të gjitha, duhet të ndjejnë obligim në raport me qytetarët e Kosovës që i kanë zgjedhur ata."¹⁹ Përveç nëse ekziston një marrëveshje politike, përndryshe nuk ekzistojnë sanksione ligjore që do të detyronin deputetët të jenë prezent në seancë parlamentare.

Efekti i kombinuar i sistemit proporcional dhe ulëseve të garantuara fuqizon partitë e vogla të cilat zakonisht i nënshtrohen një ndarjeje të pabarabartë të pushtetit. Ato mund të shfrytëzojnë këto rrethana për më shumë avantazh dhe pushtet.

4 ZGJEDHJET E REJA DHE MË SHUMË RASTE PËR GJYKATËN KUSHTETUESE

Në rastin e Etem Arifit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk kishte mundur të parandalonte kandidimin e tij në zgjedhjet e tetorit të vitit 2019, për shkak të një vendimi të Gjykatës Supreme (i datës 19 shtator 2017) që kishte vendosur se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është marrë me një vendim gjyqësor, që do të thotë se kandidati duhet të jetë shpallur fajtor me një vendim të formës së prerë dhe që gjykata t'i ketë shqiptuar dënimin plotësues "privimi nga e drejta për t'u zgjedhur."²⁰

Gjykata Kushtetuese tashmë ka prishur këtë vendim të Gjykatës Supreme, duke theksuar se neni 29.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është mjaftueshëm i qartë dhe e drejta për t'u zgjedhur shfuqizohet automatikisht në rast se kandidati/ja ka kryer vepër penale në tri vitet e fundit.²¹ Gjykata Kushtetuese është mbështetur edhe në Raportin e Komisionit të Venecias, i cili thekson se "ligjshmëria është një element i Sundimit të Ligjit që nënkupton se ligji duhet të respektohet nga individët dhe autoritetet" dhe se "ushtrimi i detyrës politike nga persona që kanë bërë shkelje

¹⁹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerëimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit*, paragrafi 83, 30 mars 2011, URL <https://gjk-ks.org/en/decision/constitutional-review-of-the-decision-of-the-assembly-of-the-republic-of-kosovo-no-04-v-04-concerning-the-election-of-the-president-2/>

²⁰ Për më shumë lidhur me vendimin e Gjykatës Supreme shih *Aktgjykimin AA.-Uzh. No. 16/2017*, 19 shtator 2017

²¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vendimi nr. 07 / V-014 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*, 6 janar 2021, URL: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-te-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-nr-07-v-014-te-3-qershorit-2020-per-zgjedhjen-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>

të rënda të ligjit, rrezikon aplikimin e këtij parimi [sundimi i ligjit], që është një nga parakushtet e demokracisë dhe kështu, rrezikon natyrën demokratike të shtetit.”²² Në këtë kuptim, gjykata konsideron se “është në kundërshtim me Kushtetutën që një person të fitojë dhe të ruajë mandatin e deputetit, nëse ai është dënuar për kryerje të veprës penale, me një vendim gjyqësor të formës së prerë.”²³

Ky vendim mund që potencialisht të afektojë një numër të përfaqësuesve të lartë të Vetëvendosjes, duke përfshirë udhëheqësin e saj Albin Kurtin. Në janar të vitit 2018, udhëheqësi i Vetëvendosjes, Albin Kurti është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës dhe për pengimin e punës parlamentare dhe ndaj tij është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një viti dhe gjashtë muaj, ekzekutimin e të cilit gjykata e ka pezulluar duke shqiptuar dënimin me kusht, në përputhje me Kodin Penal të Kosovës.²⁴ Edhe Albulena Haxhiu është shpallur fajtores dhe ndaj saj është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një viti dhe tre muaj, ekzekutimin e të cilit gjykata e ka pezulluar duke shqiptuar dënimin me kusht. Gazi lotsjellës ishte marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe ishte hedhur në Kuvend në vitin 2015 dhe në vitin 2016 nga përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje, për të parandaluar nënshkrimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe një marrëveshje me Serbinë, të ndërmjetësuar nga BE. Në shtator të vitit 2018, Gjykata e Apelit i kishte konfirmuar dënimet e shqiptuara me një vendim gjyqësor të formës së prerë.²⁵

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është bërë një problem serioz dhe ka shkaktuar një debat të madh politik dhe ligjor. Dy interpretimet kryesore lidhur me këtë vendim janë:

- Kurti ishte dënua sipas Kodit të vjetër Penal të Kosovës që specifikon se “pasojat juridike të dënimit nuk mund të krijohen kur kryesit i shqiptohet gjyba, dënimi me kusht apo vërejtja gjyqësore, ose kur kryesi lirohet nga dënimi.”²⁶ Kodi i ri Penal i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2019 nuk e trajton dënimin

²² Komisioni i Venecias, *Raport për Përfundimin e Shkelësve të Ligjit nga Parlamenti*, CDL-AD (2015) 036, paragrafi 168, 23 nëntor 2018

²³ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vendimi nr. 07 / V-014 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*, paragrafi 295, faqe. 61, 6 janar 2021, URL: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-te-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-nr-07-v-014-te-3-qershorit-2020-per-zgjedhjen-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>

²⁴ Gjykata Themelore në Prishtinë, “Shpallet aktgjykimi kundër katër të akuzuarve”, 3 janar 2018, URL <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/2018/01/03/shpallet-aktgjykimi-kunder-kater-te-akuzuarve-3/>

²⁵ Betimi për Drejtësi, “Apeli vërteton dënimet ndaj Albin Kurtit dhe deputetëve të tjerë për rastin e gazit lotsjellës,” 18 shtator 2018, URL <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verte-ton-denimet-ndaj-albin-kurtit-dhe-deputeteve-te-tjere-per-rastin-e-gazit-lotsjelles/>

²⁶ Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës – Neni 100.2

me kusht si një dënim pa pasoja juridike.²⁷

- Gjykata konsideron se asnjë person nuk mund të fitojë apo të mbajë një mandat të vlefshëm të deputetit, nëse i njëjti është dënuar për kryerje të veprës penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë, pasi që kjo është në papajtueshmëri me kërkesat e qarta të mishëruara në nenin 71.1 dhe nenin 70.3 (6) të Kushtetutës së Kosovës.²⁸ Kjo kërkesë është më tutje e përforcuar nga nenet 29 dhe 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe në nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.²⁹

Për të shmangur situata kontradiktore, Gjykata Kushtetuese ka theksuar nevojën që Kuvendi të bashkëpunojë me institucionet relevante, duke përfshirë edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK-në) dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-në).³⁰ Më 13 janar 2021, KQZ-ja dhe KGJK-ja kanë arritur marrëveshje për bashkëpunim institucional për përmbushjen e obligimeve ligjore dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese për zgjedhjet e ardhshme.³¹

Beteja ka gjasë të vazhdojë, derisa partitë politike mund të kërkojnë interpretime të mëtutjeshme ligjore dhe kushtetuese të së drejtës për të qenë kandidat për deputet, e edhe për t'u zgjedhur kryeministër. Këto sfida mund të adresohen para Panelit Zgjedhor të KQZ-së për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-it) dhe të apelojnë para Gjykatës Supreme, apo edhe deri në Gjykatën Kushtetuese.

Lista e kandidatëve të Vetëvendosjes përfshinë Albin Kurtin me numrin Një (1).³² KQZ-ja do të çertifikojë listën e kandidatëve deri më 20 janar 2021. Subjekti i tij, me siguri, do ta nominojë Kurtin edhe për kryeministër.

²⁷ Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës – Neni 93.2 specifikon se “Pasoja juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore.” Është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 janar 2019 dhe ka hyrë në fuqi tre (3) muaj pas publikimit.

²⁸ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vendimi nr. 07 / V-014 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*, paragrafi 296, faqe. 61, 6 janar 2021, URL: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-te-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-nr-07-v-014-te-3-qershorit-2020-per-zgjedhjen-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>

²⁹ Ibid.

³⁰ Ibid.

³¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, “Daka takon kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës,” 13 janar 2021, URL <https://www.kqz-ks.org/an/lajmet/daka-takon-kryesuesin-e-keshillit-gjyqesor-te-kosoves/>

³² Dega qendrore e Vetëvendosjes ka propozuar zyrtarisht tetë nga përfaqësuesit e saj për kandidatë për Kryeministër, të udhëhequr nga lideri i partisë, Albin Kurti. Përveç Kurtit, edhe Albulena Haxhiu është përfshirë si candidate. Për më shumë shih Koha, “VV-ja zyrtarizon kandidaturën e Albin Kurtit për deputet,” 13 janar 2021, URL <https://www.koha.net/arberi/254049/vv-ja-zyrtarizon-kandidaturen-e-albin-kurtit-per-deputet/>

5 KALENDARI I ARDHSHEM DHE RRUGA E GJATE DREJT FORMIMIT TE QEVERISE

Duhen muaj qe procesi elektoral i Kosovës te kompletohet duke përfshirë numërimin e votave, rinumërimin e tyre dhe çertifikimin e rezultateve.³³ Afati për inaugurimin e legjislaturës së re është 30 ditë nga dita e çertifikimit të rezultateve.³⁴ I gjithë procesi ka mundësi të zgjasë deri në fund të muajit prill, maj, apo edhe qershor.

Në zgjedhjet e fundit, Kosova ka humbur katër muaj duke qenë se partia fituese ka arritur të sigurojë një shumicë votash dhe vonoi në nominimin e një kandidati për kryeministër. Megjithatë, tashmë nuk mungon një afat kohor për negociatat për formimin e koalicionit, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 1 qershor 2020, me të cilin u konstatua se dekreti i Presidentit Hashim Thaçi, për të mandatuar Avdullah Hotin nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për postin e kryeministrit, ishte në përputhje me Kushtetutën.³⁵ Hoti u nominua pasi që Kurti nuk kishte propozuar një kandidat për kryeministër.

Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese qartësoi afatet kohore për formimin e një qeverie, ndërsa i gjithë procesi për zgjedhjen e një qeverie duhet të përfundojë brenda 60 ditëve (shiko Kalendarin Grafik dhe Rrugën drejt Formimit të Qeverisë):

- Në Kushtetutë nuk është specifikuar një afat kohor për propozimin e kandidatit për kryeministër. Megjithatë, gjykata ka vendosur se kjo “nuk nënkupton të drejtën dhe lirinë e partisë politike apo koalicionit fitues që të veprojë në një kohëzgjatje të pakufizuar.”³⁶ Qëllimi i vetëm i “konsultimeve” pasuese ndërmjet presidentit dhe partisë politike fituese apo koalicionit është nominimi i kandidatit për kryeministër.³⁷ Një mungesë e veprimit drejt propozimit të kandidatit për kryeministër nga partia politike fituese apo koalicioni, do të thotë refuzim i mandatit. Kushtetuta dhe fryma e saj parashohin se këto të

³³ Grupi për Ballkan, *Kosova 2019: Shmangia e Krizës Paszgjedhore – Rrugëtimi nga Certifikimi deri tek Inaugurimi*, 24 nëntor 2019, URL <https://balkansgroup.org/en/kosovo-2019-avoiding-a-post-electoral-crisis-a-roadmap-from-certification-to-inauguration-2/>

³⁴ Kushtetuta përcakton se afati për formimin e Kuvendit është 30 ditë pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ibid.

³⁵ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Dekretit Nr. 24/2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, të dates 30 prill 2020, 1 qershor 2020, URL <https://gjk-ks.org/en/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-dekretit-te-presidentit-te-republikes-se-kosoves-nr-24-2020-te-dates-30-prill-2020/>

³⁶ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Dekretit Nr. 24/2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, të dates 30 prill 2020, 1 qershor 2020, paragrafi 568, faqe 157, URL <https://gjk-ks.org/en/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-dekretit-te-presidentit-te-republikes-se-kosoves-nr-24-2020-te-dates-30-prill-2020/>

³⁷ Ibid., paragrafi 572, faqe 159

drejta dhe obligime nuk mund të abuzohen dhe duhet të ushtrohen në mirëbesim, në funksion të formimit të qeverisë.³⁸

- Kandidati për kryeministër nga partia fituese/koalicioni duhet të formojë një qeveri brenda 15 ditëve pas pranimit të mandatit.³⁹
- Nëse kandidati i nominuar dështon në sigurimin e një shumice të nevojshme, presidenti do të nominojë një tjetër kandidat brenda 10 ditëve, nga e njëjta apo subjekt tjetër, që mund të demonstrojë se mund të sigurojë një shumicë të re në Kuvend.⁴⁰
- Edhe kandidati tjetër kushtëzohet nga një afat 15 ditor për formimin e qeverisë, pas pranimit të mandatit.

Këto afate të definuara reflektojnë qëllimin dhe rëndësinë që Kushtetuta i ka dhënë nevojës për formimin e shpejtë të qeverisë. Dështimi në respektimin e këtyre afateve rezulton në shpërbërjen e Kuvendit dhe çon vendin në zgjedhje të reja, brenda 40 ditëve.

Në këtë rast, i nominuari për kryeministër do të ketë dy zgjidhje:

- Të kërkojë një shumicë të thjeshtë (të paktën 61 vota) për të siguruar formimin e një qeverie të re. Në këtë rast, fati i qeverisë do të kushtëzohet nga zgjedhja e suksesshme e presidentit/es të ri/e, gjë që do të kërkojë një kuorum prej 2/3 të deputetëve. Dështimi për të siguruar kuorimin do të rezultojë në shpërbërjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare.
- Të kërkojë dhe negociojë një shumicë parlamentare me dy të tretat e votave (80 vota) për të siguruar formimin e një qeverie të re dhe zgjedhjen e një presidenti të ri.

Kjo do të krijonte nevojën për negociata me partitë e tjera politike të cilat mund të jenë të vështira për të nominuarin. Negociatat do të përfshijnë bisedimet në lidhje me ndarjen e pushtetit dhe pozitave që një parti mund t'i konsiderojë si shumë për të ofruar, ndërsa të tjerat si shumë pak për të fituar. Negociatat për krijimin e institucioneve të reja kanë rezultuar, në të shumtën e rasteve, të vështira dhe të gjata – të kombinuara me konflikte politike dhe ligjore.

Posti i presidentit dhe zgjedhja e tij apo saj do të kenë rëndësi vendimtare në formimin e qeverisë dhe jetëgjatësinë e saj. Pa kompromise për këtë rol kyç,

³⁸ Ibid., paragrafi 575, faqe 160

³⁹ Ibid., paragrafi 566, faqe 157

⁴⁰ Ibid.

kriza dhe vakumi institucional do të përkeqësohet edhe nëse shpallen zgjedhje të reja apo edhe nëse formohen koalicione të reja.

KALENDAR DHE RRUGA DREJT FORMIMIT TË QEVERISË

PRESIDENTI/ja

5 Nën 20

Kryetarja e Kuvendit ka marrë funksionin e Ushtrueses së Detyrës së Presidentes

6 Jan 21

14 Shk 21

?
15 Pri 21

05 Maj 21

?
15 Maj 21

BOSHLLËKU INSTITUCIONAL

NUMËRIMI DHE ÇERTIFIKIMI

Në rast se zgjedhet deputete, e humbë rolin e U.D së Presidentes

Periudha 6 mujore për U.D së Presidentes, përfundon

Kryetari/ja i/e ri/re i/e Kuvendit merr funksionin e ushtruesit të detyrës së presidentit, pas konstituimit të Kuvendit

Kuvendi duhet të zgjedhë presidentin/en e /ri/re brenda 60 ditëve pas konstituimit të tij

KUVENDI

Kuvendi u shpërbë

ZGJEDHJET

Ish Kryetarja e Kuvendit mban mbledhje përgatitore 5 ditë para mbajtjes së seancës

Kuvendi zgjedh kryeatin/en

KONSTITUIMI I KUVENDIT

QEVERIA

21 Dhj 20

Gjykata Kushtetuese vendosi që zgjedhja e qeverisë ishte jokushtetuese

QEVERIA NË DETYRË

Procesi i formimit të qeverisë fillon pas konstituimit të Kuvendit

15 Ditë	10 Ditë	15 Ditë
Konsultimet mes presidentit/es dhe partisë politike ose koalicionit fitues për nominimin e kandidatit për kryeministër*	Për kandidatin/en e partisë fituese për formimin e qeverisë	Për presidentin/en për të nominuar një kandidat/e të ri/e për kryeministër për formimin e qeverisë
		Për kandidatin/en tjetër për kryeministër për të formuar qeverinë

60 Ditë
FORMIMI I QEVERISË SË RE

*Gjykata ka vendosur se kjo nuk nënkupton të drejtën dhe lirinë e partisë fituese për të vepruar për një periudhë të pakufizuar kohore (Rasti Nr. KO 72/20)